



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 435/16 Prot.

Tiranë, më 20/5/2014

REKOMANDIM

Nr. 50, datë 20/5/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Instituti i Sigurimeve Shoqërore" (ISSH), Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 41 datë 06.03.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Instituti i Sigurimeve Shoqërore", Tiranë, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Instituti i Sigurimeve Shoqërore" i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në drejtimin dhe administrimin e sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar është kontrollues publik, me veprimtari administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, duke zbatuar legjislacionin që rregullon sistemin e sigurimeve shoqërore në Shqipëri

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluesi mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale të punonjësve të tij, si dhe për një kategori të gjerë subjektsh të dhënash personale (kontribuues, individë të ndryshëm etj), me qëllim futjen në skemën e sigurimit të detyrueshëm, vullnetar, suplementar, për të përfituar pension pleqërie, invaliditeti, familjar, pension për paafhtësi nga sëmundjet, aksidentet, lejet e lindjeve, trajtime të tjera për kategori të ndryshme individësh (ushtarakë, punonjës nëntokës, invalidët e luftës, veterane etj).

Kontrolluesi mbledh të dhëna personale në rrugë manuale dhe elektronike, nëpërmjet dokumentacionit që subjektet paraqesin për krijimin e dosjeve individuale të përfitimeve të

ndryshme, dosjeve individuale të punës për kategorinë e subjekteve të të dhënave “punonjës”, si dhe dokumentacionit nga korrespondencat verifikuese me institucione të treta.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se; mbledhja, përpunimi i të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike nga kontrolluesi ISSH, për kategoritë e ndryshme të të dhënave personale, bëhet duke respektuar procedurat, aktet dhe rregulloret e brendshme, në të cilat përcaktohet dokumentacioni që paraqitet nga subjekti i të dhënave personale, në funksion të qëllimit për të cilat të dhënat mblidhen dhe përpunohen.

Nisur nga konstatimet e kontrollit administrativ të zhvilluar, shqyrtimit të provave të administruara konkludojmë se;

➤ Kontrolluesi gjatë mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave, në rrugë manuale dhe elektronike, (në formularë të ndryshëm të hartuar, në aplikime on line në faqen zyrtare ne internet), nuk informon subjektet e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Gjithashtu në faqen e tij zyrtare në internet www.iss.gov.al, kontrolluesi nuk ka publikuar “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Mungesa e informimit të shprehur është shkelje e nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Vlerësojmë se informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur të dhënat mblidhen nga subjektet e interesuar, informacioni mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave.

Autoriteti i Komisionerit vlerëson parimin e transparencës së çështjeve të ndryshme sidomos edhe në faqen tuaj të internetit si kontrollues, por thekson edhe rëndësinë e transparencës në përpunimin e informacionit të subjekteve të të dhënave në mënyrë që këta të fundit të kenë dijeni mbi: personat që njihen me të dhënat e tyre, qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave, kujt do t'i përhapen të dhënat, mbrojtjen e privatësisë, etj. Për këtë arsye çdo individ/subjekt i të dhënave personale ka të drejtën e mbrojtjes së duhur të të dhënave të tij personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet për aq sa është i nevojshëm, i drejtë, i ligjshëm dhe proporcional.

Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqes tuaj të internetit duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Kontrolluesi mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale nëpërmjet sistemit CCTV, regjistrim me kamera në ambientet e serverëve dhe në arkivin qendrorë dhe nuk ka të përcaktuara rregulla të shkruara, për mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, sigurisë, kofidencialitetin e të dhënave personale, përcaktimin e nivelit të aksesit për këtë lloj përpunimi, informimin e subjekteve të të dhënave, përhapjen drejt palëve të treta etj., sikundër parashikohet ne Udhëzimin nr. 3 dt. 05/03/2010 “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit ne ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

Hartimi i rregullave të veçanta për këtë lloj përpunimi të të dhënave personale është një masë sigurie shumë e domosdoshme për vetë faktin se risku për humbjen, shkatërrimin e të dhënave personale të dixhitalizuara dhe të ruajtura në servera apo arkiva qendrore është shumë më i madh. Të gjithë personat e kontrolluesit që do të kenë akses në këtë lloj përpunimi, janë të detyruar të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit.

➤ Kontrolluesi në të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e lidhura me palët e treta, të cilëve u ka deleguar shërbime për llogari të vet, (*kontrata e shërbimit, zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve informatike dhe fizike, marrëveshjet "Për pagesën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" me Postën Shqiptare sh.a, marrëveshjet me Bankat e Nivelit të Dytë etj*), nuk ka përfshirë rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet që mbartin këto palë të treta, për garantimin e përdorimit të ligjshëm të sigurt dhe konfidencial të të dhënave personale.

Në këtë rast kontrolluesi ka shkelur nenin 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 19 datë 03/08/2012 "*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se përcaktimi në kontratë i detyrimeve për përdorimin e ligjshëm dhe të sigurisë të të dhënave personale është detyrë parësore e kontrolluesit. Ligjshmëria, siguria dhe konfidencialiteti për përdorimin e të dhënave personale të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe akteve të Komisionerit duhet të jetë gjithmonë nën vëzhgim dhe kontroll nga ana e kontrolluesit.

➤ Në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, nuk janë përfshirë parimet e përgjithshme, kushtet dhe kriteret e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.

Komisioneri vlerëson se pavarësisht se aktmarrëveshja është hartuar në vitin 1998 dhe ratifikuar në vitin 2003, kohë në të cilin ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk ka qenë në veprim, kontrolluesi në bashkëpunim me përfaqësuesit e tij në këtë marrëveshje duhet të realizojnë veprime konkrete, për përgatitjen e aneksi të veçantë për tju bashkëlidhur marrëveshjes, në të cilën të përfshihen parimet e përgjithshme, kushtet dhe kriteret e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale. Kjo për faktin se jo vetëm në këtë marrëveshje të lidhur por në çdo rast dhe në çdo kohë kur kemi shkëmbim të të dhënave personale jashtë Republikës së Shqipërisë, kemi të bëjmë me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Kontrolluesi në rast të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, duhet të mbajë parasysh kriteret ligjore të nenit 8 dhe 9 të ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe Vendimi Nr. 3 datë 20/11/2012 "*Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*"

Autoriteti i Komisionerit rekomandon se kontrolluesi ISSH dhe Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale si përfaqësuese në lidhjen e aktmarrëveshjeve në fushën e sigurimeve shoqërore, mbrojtjes shoqërore, në çdo rast duhet të konsultojnë dhe të sjellin për mendim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, draftin mbi parimet e mbrojtjes së të dhënave personale që do të jetë pjesë e aktmarrëveshjeve të lidhura.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18/2, 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi ISSH gjatë mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike (në formularë të ndryshëm dhe aplikime on line në faqen zyrtare ne internet), të bëjë informimin e subjekteve të të dhënave personale për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korigjim të të dhënave. Në faqen zyrtare në internet www.isssh.gov.al, të publikohen në një rubrikë të veçantë "*politikat e privatësisë*" (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. (Disa nga këto parime do t'i gjeni në Opinionin "*Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat*" publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al).

2. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr.19 datë 03/08/2012 "*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit ne rastet e përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip ne rastet e këtij delegimi*" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kontratat dhe marrëveshjet e lidhura me palët e treta, të cilëve u janë deleguar shërbime për llogari të kontrolluesit, (kontrata e shërbimit, zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve informatike dhe fizike, marrëveshjet "*Për pagesën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe arkëtimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*" me *Postën Shqiptare sh.a*, marrëveshjet me *Bankat e Nivelit të Dytë etj*), të përfshihen rregulla të qarta mbi të drejtat dhe detyrimet që mbartin palët kontraktuese për garantimin e përdorimit të ligjshëm të sigurt dhe konfidencial të të dhënave personale.

3. Në zbatim të neneve 8,9, 27,28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, kontrolluesi ne bashkëpunim me Ministrinë e Punëve dhe Çështjeve Sociale, të përgatitë një aneks të veçantë për t'ja bashkëlidhur marrëveshjes, së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, në të cilën të përfshihen parimet e përgjithshme, kushtet dhe kriteret e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.

Kontrolluesi dhe Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale si përfaqësuese në lidhjen e aktmarrëveshjeve në fushën e sigurimeve shoqërore, mbrojtjes shoqërore, me shtete të tjera, në çdo rast duhet të bëjnë pjesë të aktmarrëveshjeve, parimet e mbrojtjes së të dhënave personale. Draftin mbi parimet për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet ta konsultojnë dhe të sjellin për mendim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. Në zbatim të neneve 6, 18, 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, udhëzimit të veçantë nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "*Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", kontrolluesi ISSH, të hartojë rregullore të shkruar, për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, aksesin e autorizuar, nëpërmjet përdorimit të video-survejimit (regjistrim me kamera). Të bëhet informimi i subjekteve të të dhënave personale, duke u vendosur tabelat informuese për këtë lloj përpunimi sipas standardit të miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

6. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit.. “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

